



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 469/3 Prot.

Tiranë, më 21. 05. 2024

**V E N D I M**

Nr. 147, datë 21.05.2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>2</sup>, të ndryshuar, shqyrtoi ankesën nr.55, datë 19.03.2024, të paraqitur nga z. S. F, znj. V. K dhe L. F, kundër Shoqërisë së Transportit të udhëtarëve EL-ALBA TRANS sh.p.k, me numër NIPT J62014003V, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>3</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjektet ankues, në mes të tjerash informojnë se: “Në datë 13.03.2024, ora 06.00, kanë qenë duke udhëtuar nga Tirana në Vlorë me autobusin me targë AB 368 KY. Gjatë udhëtimit deklarojnë se, nga linja e transportit publik iu është kërkuar të paguajnë biletën e plotë, duke mos iu njohur e drejta për të udhëtuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar. Në orën 15.00 do të ktheheshin përsëri nga Vlora në Tiranë, po me të njëjtin autobus ku iu janë kërkuar të paguajnë të plotë biletën e transportit. Nga ankuesit janë kërkuar biletat të cilat nuk

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

*disponoheshin nga shoferi i këtij autobusi dhe biletat u prenë me targën AA 716 YY të një mjete tjetër, me një vlerë joreale sa u kërkua të paguhej prej tyre (600 lekë) por në vlerën 480 lekë”.*

Subjektet ankues, kërkojnë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen masave ndaj personave përgjegjës, pasi na kanë injoruar publikisht.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të LMD, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ankuesit, moshë dhe raca, janë shkaqe të mbrojtur nga neni 1, i LMD, ku parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të LMD. Konkretisht në nenin 20, pika 1, të po këtij ligji, përcaktohet se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.....”*

Sipas nenit 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në kushtet kur, ankuesit nuk kishin mundur të identifikonin subjektin i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Tiranë-Vlorë-Tiranë, me të cilën kishin udhëtuar në datën 13.03.2024, datë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuuese, Komisioneri me shkresën nr. 469/2, datë 26.03.2024, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim.

Me shkresën nr. 6046/1, datë 04.04.2024, DPSHTRR, informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimi i kryer në sistemin e-Transport, rezulton se në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Tiranë-Vlorë-Tiranë, është licencuar shoqëria "EL-ALBA TRANS" shpk, me NIPT J62014003V, mbajtës i licencës me nr.166, lëshuar në datë 21.07.2022, me afat vlefshmërie deri në datë 20.07.2027”.*

Pas plotësimit të ankesës dhe identifikimit të subjektit, u konstatua se nga pikëpamja formale, ankesa objekt shqyrtimi plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 dhe 334 të LMD. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj, duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.469/6 prot., datë 16.04.2024, Komisioneri, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shoqëria "EL-ALBA TRANS" shpk, me NIPT J62014003V, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë. Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Shoqëria "EL-ALBA TRANS" shpk me shkresën nr.74 prot., datë 24.04.2024<sup>4</sup>, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se:

*“Shoqëria e transportit të udhëtarëve "EL -ALBA TRANS" shpk shpreh indinjatën e saj për situatën e ndodhur të pretenduar nga subjektet ankues, ku sipas shkresës tuaj dhe shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës nga ankuesit: znj. L. F, znj. V. K dhe z. S. F, janë trajtuar në mënyrë diskriminuuese, për shkak të "aftësisë së kufizuar" nga personeli drejtues (shofer) i autobusit duke e imponuar për pagesën e tarifës së plotë të biletës ndërkohë që ankuesit kishin paraqitur librezat e verbërisë për të paguar gjysmë bilete për udhëtimin me linjën e transportit publik ndërqytetës Tiranë -Vlorë-Tiranë.*

*Menjëherë shoqëria "EL-ALBA TRANS" shpk u vu në lëvizje për sqarimin dhe evidentimin e personelit drejtues të mjetit apo faturinon në këtë rast, shkaktar për situatën e ndodhur në datë 13.03.2024 në stacionin e autobusëve në qytetin e Vlorës. Për të marrë një informacion të saktë për situatën e ndodhur, nga ana jonë u morën hapat si më poshtë vijon:*

*U përqendruam të grafiku i lëvizjes së autobusëve të muajit Mars 2024 për të evidentuar drejtuesit e mjeteve dhe faturinove që kanë qenë në punë atë ditë në linjën Tiranë-Vlorë-Tiranë.*

---

<sup>4</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 469/7 prot., datë 24.04.2024.

- U bë mbledhja me të gjithë personelin drejtues mjetesh dhe faturino ku u bë prezente situata e pretenduar e ndodhur në datë 13.03.2024 në stacionin e autobusëve në qytetin e Vlorës.

Nga pyetja e të gjithë personelit më sipër, shofer dhe faturino ata konfirmuan faktin se ishin në dijeni për ngjarjen e ndodhur në datë 13.03.2024, dhe shkaktar i kësaj situatë është drejtuesi i mjetit autobus punonjësi Xh. D.

Menjëherë pas evidentimit të këtij fakti, pranimit nga punonjësi shkaktar u vendos:

- Marrja menjëherë në kontakt me anë të celularit me subjektet ankues.

- Pasi u lidhëm me subjektet ankues, i kërkuam ndjesë për situatën e shkaktuar. U premtuan se kjo sjellje dhe ngjarje nuk do të përsëritet më.

- Për punonjësin morëm vendim për paralajmërim për pushim nga puna. Nga ana e subjekteve ankues na u premtua se kjo ndjesë e kërkuar nga punonjësi Xh. D dhe si shoqëri do të përcillet dhe te organi juaj.

Shoqëria "EL-ALBA TRANS" shpk ushtron veprimtarinë e transportit rrugor të udhëtarëve prej 19 vjetësh. Ky është një rast i veçantë për të cilin kërkojmë ndjesë.

E licencuar për transportin e udhëtarëve në linjat e rregullta ndërqytetëse ofrohet dhe shërbimi i transportit i personave me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër, bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara nga legjislacioni specifik e konkretisht bazuar në Udhëzimin e Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës nr.5627 prot., datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendi ku citohet se: Mbjtësi i licencës dhe i kësaj certifikate mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr. 7889/94, të ndryshuar, nr. 7663/93, nr. 8626/00, të ndryshuar, në të cilat përcaktohet:

b) Për transportin rrethqytetës dhe ndërqytetës :

- "invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë me 50% të vlerës së biletës", si dhe për zbatimin e ligjeve nr. 8098/96, të ndryshuar, nr. 8153/96 të ndryshuar nëpërmjet ligjit 26/2012 ku përcaktohet se "të verbrit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune udhëtojnë me 50% të vlerës së biletës".

- Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjithë personat që i përfitojnë këto lehtësi në transportin në linja të rregullta, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e tyre të ndenjes.

Shoqëria "EL-ALBA TRANS" shpk gjatë gjithë veprimtarisë së saj është angazhuar maksimalisht për të respektuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në zbatim të kriterëve të

*udhëzimeve, ligjeve dhe akteve nënligjore të nxjerra në vite për gëzimin e lehtësirave financiare në shërbimin e transportit për këtë kategori të udhëtarëve.*

*Situatën e pretenduar të ndodhur e vlerësuam maksimalisht dhe e analizuam me qëllim parandalimin e situatave të tilla dhe marrjen e masave si:*

*- Ushtrimi i kontrollit dhe monitorimit në vazhdimësi për zbatimin nga ana e personelit shofer mjetesh dhe faturino të lehtësirave financiare të parashikuar nga legjislacioni specifik për kategoritë e udhëtarëve me aftësi të kufizuara, të verbërit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.*

*- Afishimi në bordin e çdo mjeti të rregullores të udhëtimit si dhe në veçanti afishimi në vende të dukshme të civateve të ligjeve dhe udhëzimeve që kanë të bëjnë për lehtësirat që përfitojnë kategoritë e udhëtarëve me aftësi të kufizuar në shërbimin e transportit.*

*- Për parandalimin e ndonjë konflikti dhe situatave mes faturinove dhe udhëtareve të kategorive me aftësi të kufizuar u vendos se në raste të problematikave të tilla të lajmërohen dhe vihen në dijeni menaxherët e linjave dhe në stacionin fundor të udhëtimit të gjejnë një zgjidhje të pranueshme midis palëve.*

*- Nisur nga fakti se në shumë raste nga udhëtarët e kategorive me aftësi të kufizuar janë paraqitur pranë faturinove dokumentacion fotokopje e pa noterizuar të Librezave, Dëshmime, Vendimeve të KMCAP etj, u vendos që nëpërmjet kësaj shkresë dhe mjeteve të tjera të informimit t'u bëhet e ditur Shoqatave dhe Organizatave të ndryshme se në çdo rast udhëtimi nga personat me aftësi të kufizuar do t'u njihen dhe pranohen si dokumentacion të vlefshëm udhëtimi vetëm ato që përcakton ligji për ta për secilën kategori, dokumentacion origjinal ose fotokopje të noterizuar në mënyrë që të përfitojnë lehtësirat financiare përkatëse gjatë udhëtimit”.*

2. Me shkresën nr.469/8 prot., datë 25.04.2024 Komisioneri ka kërkuar nga Shoqëria "EL-ALBA TRANS" shpk, informacion shtesë për sqarimin e mëtejshëm të kësaj çështje por dhe dokumentimit me prova konkrete të masave të marra nga Shoqëria.

3. Me shkresën nr.469/9 prot., datë 25.04.2024, Komisioneri i komunikoi ankuesve parashtrimet e depozituara nga subjekti kundër të cilit kanë paraqitur ankesën.

4. Me shkresën nr.74/1 prot., datë 04.05.2024<sup>5</sup>, Shoqëria "EL-ALBA TRANS" shpk, me NIPT J62014003V ka dërguar informacionin shtesë të kërkuar nga ana e Komisionerit, duke parashtruar:

*“Është e evidente që punonjësi Xh. D, mori kontakt me bisedë telefonike nga numrat e kontaktit të shënuara në shkresë nga subjektet ankues ku i ka kërkuar ndjesë për situatën e shkaktuar. Nga deklaratimet e drejtuesit të mjetit më është komunikuar se ndjesa e kërkuar prej tij te subjektet ankues do të përcillet nga këta të fundit dhe te organi juaj. Për biseda në lidhje me rregullimin e situatës me subjektet ankues unë si administrator jam vënë në dijeni vetëm nga deklaratimet e punonjësit.*

---

<sup>5</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 469/10 prot., datë 08.05.2024.

*Për rregullimin e situatës së mësipërme, ju lutemi nëse subjektet ankues paraqesin përpara jush një ankim të tillë apo kthimin e vlerës financiare të paguar tepër nga subjektet për biletat e udhëtimit, të paraqiten në zyrën e shoqërisë duke komunikuar paraprakisht me Administratorin z. Arben Brahimi me nr.cel: 0672022786 për vendndodhjen e tij në zyrë apo në udhëtim në linjë.*

*Për masat e marra mbi monitorimin dhe informimin e personelit që situata të tilla mos të përsëriten më, ju bëjmë të ditur se nga ana jonë nuk ka munguar asnjëherë informimi i personelit me të gjitha ndryshimet ligjore dhe udhëzimet e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë të Kodit dhe rregullave të qarkullimit rrugor dhe konkretisht në shërbimin e transportit të personave me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër, bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara nga legjislacioni specifik e konkretisht bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr.5627, datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit.*

*Mjetet e informimit janë kryer si me anë të komunikimit dhe me anë të dokumentacionit shkresor si:*

*- Në bordin e mjetit, çdo drejtues mjeti dhe faturino përveç dokumentacionit të mjetit, objekt i organeve të kontrollit në rrugë ka dhe rregulloren e udhëtimit ku janë të shënuara dhe cituara dhe zbatueshmëria e ligjeve për "personat e kategorive të caktuara" në transportin ndërqytetës.*

*- Mbrapa çertifikatës të çdo mjeti "Dispozita të Përgjithshme ", janë të shkruara qartë citate të ligjit për këto kategori dhe mbajtja përgjegjësi nga moszbatueshmëria e tyre nga personeli i mjetit në udhëtim.*

*Në transportin ndërqytetës të udhëtarëve nuk është e detyrueshme afishimi në bordin e mjetit apo në vende të tjera të dukshme nga udhëtarët, i rregullores apo citimi i ligjeve apo parullave të ndryshme, përveçse emërtimi i linjës dhe shoqëria e transportit përkatëse.*

5. Me shkresën nr.469/11 prot., datë 09.05.2024 Komisioneri i komunikoi ankuesve, informacionin shtesë të dërguar nga ana e shoqërisë për të bërë kundërshtimet e tyre.
6. Me e-mail-in e datës 11.05.2024 pala ankuese ka dërguar pranë Komisionerit parashtrimet e veta si më poshtë:

*"Shoqata Kombëtare Shpresë për të Verbërit falenderon për bashkëpunimin Komisionerin kundër diskriminimit dhe mbështetjen që i jep shoqatës në realizimin e objektivave për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive për personat me aftësi të kufizuara, në korrespondencën tuaj për kompaninë "El-Alba Trans" shpk, ne vlerësojmë qëndrimin e kësaj kompanie për masat e marra, për të garantuar të drejtat e personave të verbër për të udhëtuar në shërbimet e transportit publik sipas ligjit dhe marrjen e masave nga kjo kompani që në të ardhmen nuk do të ndodhin ngjarje si ajo e ankesës nr. 55, dt. 19.03.2024, pasi ky ishte dhe qëllimi i kësaj ankese. Ju bëjmë me dije se ne si shoqatë do të vazhdojmë të jemi në monitorim të përhershëm për të gjithë shërbimet e transportit publik urban dhe interurban dhe do të denoncojmë çdo rast të shkeljes së*

*lirive dhe të drejtave të personave të verbër që bëhet nga ky shërbim, mbetemi me shpresë që shoqëria "El Alba Trans" shpk, të mos ndodhë përsëri një ngjarje e tillë me personat e verbër”.*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb dhe pala ankuese nëpërmjet e-mail të datës 11.05.2024, por dhe të komunikimit telefonik me inspektorin e çështjes ka deklaruar se tërhiqet nga ankesa, pasi ka arritur në një zgjidhje me mirëkuptim të problematikës së bashku me subjektin kundër të cilit ka paraqitur ankesën, Shoqërinë "EL-ALBA TRANS" shpk, me NIPT J62014003V.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se, qëllimi për të cilin është filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është paraqitur ankesa.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 55 regjistri, datë 19.03.2024, të paraqitur nga z. S. F, znj. V. K dhe znj. L. F, kundër Shoqërisë së Transportit të udhëtarëve EL-ALBA TRANS shpk, me numër NIPT J62014003V, duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.55, datë 19.03.2024, pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Rekomandohet që Shoqëria e Transportit të udhëtarëve EL-ALBA TRANS shpk, me numër NIPT J62014003V, me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masat e mëposhtme:
  - Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi;
  - Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe në kontratat individuale të punës, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
  - Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.
3. Shoqëria e Transportit të udhëtarëve EL-ALBA TRANS shpk, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**



Konceptoi: L. Jani, Inspektore DHA  
Miratoi: V.Bushati, Drejtore DHA  
Datë: 21.05.2024